

Përgjigje pozitive kundrejt sjelljeve të papërshtatshme

Përgjigjet jo verbale

1. Informohuni Informohuni se çfarë ndodh në klasë gjatë gjithë kohës	-Ecni përreth klasës. Sigurohuni që arrini të mbikqyrni nga çdo pozicion. -Mbani kontakt me sy me nxënësit. -Përpiquni që të kuptoni sinjalet paraprake të sjelljeve të papërshtatshme nëpërmjet ndërveprimeve me nxënësit apo kontaktit me sy.
2. Kontakti me sy dhe shprehjet faciale	-Komunikoni me sy me nxënësit për t`iu dërguar mesazhin : ``Unë jam në dijeni të veprimeve dhe sjelljeve tuaja.``
3. Gjestura/pozicioni i trupit	Gjestura përfshin mënyrën sesi qëndroni në klasë, mënyrën sesi afroheni drejt nxënësve, pozicionin e duarve, tundjen e kokës etj
4. Qëndrimi	-Lëvizni përreth klasës -Qëndroni afër një nxënësi që shfaq shenja të sjelljes së papërshtatshme -Vendosini bankat në pozicione që ju mundësojnë kontaktin e shpejtë me secilin nxënësi
5. Planifikimi i qëndrimit	-Uluni ndërmjet dy nxënësve -Qëndroni gjithmonë përballë nxënësve
6. Pritja	-Mos reagoni menjëherë me fjalë -Prisni deri sa nxënësit të kuptojnë se duhet të sillen në mënyra të pranueshme socialisht

7. Regjistrimi i sjelljes

-Kushtojini vëmendje sjelljeve të çdo nxënësi.

-Regjistroni sjelljen që ata shfaqin